



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 282 Prot.,

Tiranë, më 06.06.2018

Lënda: Jepet mendim për projekt marrëveshje bashkëpunimi

Drejtuar: Z. Kujtim ÇASHKU

Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”

Për dijeni: Zonjës Mirela KUMBARO (FURXHI)

Ministër i Kulturës

Zonjës Lindita NIKOLLA

Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Të nderuar,

Në datën 04.05.2018, Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, ka paraqitur zyrtarisht projekt marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”, e cila ishte finalizim i disa takimeve pararendëse për përcaktimin e piketave të bashkëpunimit.

Gjatë këtyre takimeve u propozua hartimi i një “Memorandumi Mirëkuptimi”, për të cilin u shprehëm të interesuar, nëse kjo do të ndihmonte sadopak në ndërtimin e një marrëdhënieje ndërmjet QKK dhe Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”.

QKK u shpreh e gatshme të mirëpresë propozim për “Memorandum Mirëkuptimi”, bazuar mbi kuptimin juridik të këtij termi:

“Memorandum Mirëkuptimi është një marrëveshje jo detyruese midis dy ose më shumë palëve që përshkruajnë kushtet dhe detajet e një mirëkuptimi, duke përfshirë kërkesat dhe përgjegjësitë e secilës palë. Një memorandum mirëkuptimi nuk është ligjërish i detyrueshëm por shihet si një dokument serioz nga ligji. Ngjashmëritë e tjera kryesore midis të gjitha Memorandumeve të Mirëkuptimit janë ato që nuk janë ligjërish të detyrueshme dhe nuk përfshijnë shkëmbimin e parave”.

Nisur nga vullneti i shprehur paraprakisht, mirëpritëm propozimin e dërguar nga përfaqësuesit e Akademisë “Marubi”, por konstatuam se zyrtarisht u bë propozim për një “Projekt marrëveshje bashkëpunimi”.

Duke e lexuar me vëmendje propozimin në fjalë, arritëm në përfundimin se ajo që synohet të arrihet nëpërmjet kësaj projekt marrëveshje, nuk është gjë tjetër veçse ajo që propozohet në projekt vendimin e KM, “Për riorganizimin e shkollës së lartë jopublike “Marubi”, në Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi” dhe dhënien e statusit të veçantë këtij institucioni të arsimit të lartë”.

Dy janë kërkesat e shprehura në thelb të projekt marrëveshjes së propozuar:

- e para: të krijohet mundësia që Akademia “Marubi” të financohet pa aplikuar, pa projekt dhe pa ndjekur procedurën normale si çdo subjekt tjetër.
- e dyta: Akademia “Marubi” të financohet pa u bazuar në një shifër konkrete, por në përqindje, e cila në projekt vendimin e KM ishte 50%, ndërsa në rastin e projekt marrëveshjes së propozuar është 56%.

Në rastin e projektvendimit të KM, ne e kemi shprehur mendimin tonë, nëpërmjet përgjigjes drejtuar Ministrisë së Kulturës në datën 02.02.2018. Ministria e Kulturës i mori në konsideratë objeksionet tona, që u pasqyruan në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 229, datë 26.4.2018, në të cilin u përjashtua buxheti i QKK-së si një nga burimet e financimit të Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”.

Bazuar në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, në përkufizimin e termit producent, ndër të tjera thuhet: “... përjashtohen personat juridikë publikë, të cilët nuk ndjekin qëllim fitimprurës”, pra aplikimi në QKK duhet të bëhet nga subjekte juridike, apo fizike, të regjistruar pranë QKK-së.

Nëpërmjet propozimit për nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje bashkëpunimi, kërkohet që Akademia “Marubi” të trajtohet ndryshe nga të gjithë subjektet e tjera, pra duke anashkaluar procedurat që aplikohen

për t'i dhënë mbështetje financiare të gjitha shtëpive kinematografike të rregjistruara në QKK. Ky përjashtim kërkohet të bëhet nëpërmjet përcaktimit që bëhet në Nenin 30, "Dispozita përfundimtare", të projekt marrëveshjes së bashkëpunimit: "i. Kjo marrëveshje është sui-generis, nominative dhe jo normative, për pasojë nuk përbën precedent". Baza ligjore dhe arsyet pse bëhet një propozim i tillë mbeten të pa argumentuara.

Në parim shprehim qëndrimin se:

Çdo subjekt që kërkon të përfitojë mbështetjen e QKK, duhet të kalojë nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve dhe asnjë akt administrativ qoftë marrëveshje/memorandum/kontratë, etj., nënshkruar ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe një subjekti privat, nuk mund t'i mbivendoset këtij rregulli.

Sa më sipër, nuk do të thotë që QKK e shikon të pamundur mbështetjen financiare të Akademisë, përkundrazi.

Propozimi ynë për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, është aplikimi në QKK me projekte konkrete, të cilët më pas do të kalojë në vendimmarrjen e Këshillit Miratues të Projekteve.

Mendojmë se fusha me interes për aktivitetin e Akademisë "Marubi", për të cilat QKK mund të japë mbështetje financiare janë si më poshtë:

1. Aplikimi me projektet e studentëve, për të përfituar financimin e prodhimit të filmave të tyre.
2. Realizimi i workshop-eve me qëllim ngritjen e nivelit profesional të studentëve / kineastëve.
3. Mbulimi i pjesshëm, ose i plotë i bursës për studentët më të mirë të çdo viti akademik.

Në përfundim, Qendra Kombëtare e Kinematografisë shpreh angazhimin maksimal për të bashkëpunuar dhe ndihmuar Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi", brenda mundësive që krijon legjislacioni në fuqi, të cilat ekzistojnë dhe janë realisht të mundshme për t'u aplikuar.

Ju falënderoj paraprakisht për mirëkuptimin.

KRYETARI

Ilir BUTKA



Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.77. Tiranë
Tel. 0422378 004
E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al
www.nationalfilmcenter.gov.al